



Nr. 3848/2 Prot,

Elbasan, me 23.8 2021

## NJOFTIM PËR PUNËSIM

Bashkia Elbasan nëpërmjet Agjensisë së Sherbimeve Publike, fillon zbatimin e projektit “Punë për komunitetin” në zonat me rrezikshmëri të lartë nga përmytjet, me qëllim përmirësimin e gjendjes fizike dhe funksionin e kanaleve kulluese, si dhe të gjendjes ekonomike dhe sociale në komunitet, duke patur parasysh nivelin e papunësisë së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Ky projekt do të zgjasë 3 muaj dhe mbështetet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) nëpërmjet GIZ në Shqipëri. Për gjatë 3 muajve projekti do të punësojë një numër përfituesish në komunitet, të cilët do të punojnë kryesisht për pastrimin dhe sistemimin e kanaleve kulluese në zonat e ndikuara nga përmytjet.

***Nëse jeni të interesuar të ndihmoni komunitetin dhe vendbanimet tuaja, kundrejt një page mujore, ju lutemi të paraqiteni pranë zyrës së Burimeve Njerezore në Bashkinë Elbasan, deri me datë 30.08.2021, duke patur me vete një kopje të kartës së identitetit, adresën e banesës tuaj, numrin e llogarisë bankare dhe një numër kontakti.***

Projekti inkurajon aplikimet nga grupet në nevojë dhe të grave nga këto komunitete.

Ju mirëpresim!

Punë për Komunitetin



Sekretari i Pergjithshem  
Aulona Bylykbashi